



Data: 05.02.2019

Ref.: 145/19D

Në mbështetje të Nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe Neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" si më poshtë:
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe);
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën boshnjake);
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën turke), dhe
 - Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc, 120 ECTS.
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, IAL- të janë të obliguara të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Sipas pikës 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoi në detaje dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës

të programeve nga IAL-të. Pasi analizoi fushat e studimit për secilin prej tyre, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

1. Për programin e studimit: *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe)*, bartës në këtë program Universitetit i Prizrenit "Ukshin Hoti" (tash e tutje Universiteti) ka paraparë këtë staf: Ismet Temaj, Fahredin Shabani, Shemsi Morina, dhe Ajka Aljilji.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD, dhe me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që dy nga anëtarët e stafit akademik nuk i përkasin fushës relevante të programit të studimit.

Sipas dokumentacionit të kualifikimit të stafit akademik, Fahredin Shabani është PhD në Histori, ndërsa Ajka Aljilji është PhD në Shkencat Teknike në fushën e Teknologjisë. Asnjëri nga këta të dy nuk i përket fushës së programit të studimit. Ajka Aljilji përveç që nuk është nga fusha e studimit, e njëjta ka diplomë të lëshuar nga i ashtuquajti "Universiteti i Prishtinës" në Mitrovicë të Veriut, në diplomën e së cilës shkruan Republika e Serbisë. Nga sa u tha me lartë asnjëri nga katër bartësit nuk i përket fushës së programit të studimit, dhe rrjedhimisht nuk mund të jetë bartës i këtij programi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën boshnjake)*, bartës të këtij programi Universiteti nuk ka prezantuar asnjë staf akademik, pasi që bazuar në Nenin 26 pika 5.3.10 e UA për Akreditim "*Programet e studimit në gjuhën e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri më tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e ofruara në gjuhën shqipe, me kushte që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA*".

Meqenëse dispozita e referuar me lartë i lejon ofrimin e programeve në gjuhën minoritare edhe pa stafin akademik me gradën PhD paralelisht me programin në gjuhën shqipe, dhe bazuar në dispozitivin e këtij sipas se cilit konfirmohet tërheqja e akreditimit për program në gjuhën shqipe, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 dhe pika 5.3.10 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën boshnjake)*.

3. Për programin e studimit: *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën turke)*, si bartës të këtij programi Universiteti nuk ka prezantuar asnjë staf akademik, pasi që bazuar në nenin 26 pika 5.3.10 e UA për Akreditim "*Programet e studimit në gjuhën e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri më tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e ofruara në gjuhën shqipe, me kushte që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA*".

Meqenëse dispozita e referuar me lartë i lejon ofrimin e programeve në gjuhën minoritare edhe pa stafin akademik me gradën PhD paralelisht me programin në gjuhën shqipe, dhe bazuar në dispozitivin e këtij sipas së cilit konfirmohet tërheqja e akreditimit për program në gjuhën shqipe, KShC vendosi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 dhe pika 5.3.10 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën turke)*.

4. Për programin e studimit: *Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc, 120 ECTS*, bartës të këtij programi Universiteti ka paraparë këtë: Agon Koka, dhe Munever Muyo.

Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, "IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor", IAL- të duhet të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që Agon Koka nuk ka bërë deklarin sipas nenit 30 të UA për Akreditim, dhe rrjedhimisht AKA nuk ka asnjë dëshmi me të cilën do të konfirmonte kualifikimin dhe fushën e studimit për personin në fjalë. Mbi këtë bazë nuk mund të konsideron z.Koka si bartës të programit të studimit. Ndërsa Munever Muyo është PhD në Shkencat e Matematikës, dhe jo nga fusha e programit të studimit *Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi*.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi, MSc, 120 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

